

## NUK DUA MË SHUMË NË JETË SESA TË SHOH KOSOVËN E LIRË, PAS KAQ SHUMË VITEVE TË TMERRIT.

Intervistë ekskluzive për Bota Sot e Albanologut kanadez Robert Elsie,  
anëtar i sapozgjedhur në Akademinë e Shkencave të Kosovës

Për kontributin e veçantë që ka dhënë në fushën e gjuhësisë dhe të letërsisë shqiptare, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës e zgjodhi para tri javësh albanologun kanadez dr. Robert Elsin, anëtar (të jashtëm) të kësaj Akademie.

I lindur në Vankuver të Kanadasë, Elsie ndoqi Universitetin e Kolumbisë Britanike, ku mbaroi studimet e filologjisë klasike dhe të gjuhësisë më 1972. Më pas ndjek disa shkolla të larta dhe institute, si Universitetin e Lirë të Berlinit Perëndimor, Shkollën Praktike të Studimeve të Larta në Paris, në Institutin e Dublinit për Studime të Avancuara në Irlandë, Universitetin e Bonit, ku edhe mbrojti doktoraturën më 1978. Që nga ky vit pati mundësi të vizitojë Shqipërinë disa herë në kuadrin e takimeve shkencore midis Institutit të Gjuhësisë së Universitetit të Bonit dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ka marrë pjesë vite me radhë në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Prishtinë e më pas në Tiranë. Pas studimeve universitare, ai punoi për Ministrinë e Punëve të Jashtme gjermane në Bon. Është anëtar i Shoqatës së Evropës Juglindore, si dhe anëtar nderi i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Jeton në një fshat malor të Gjermanisë, afër kufirit belg. Albanologu Elsie ka botuar me dhjetëra libra në anglisht, gjermanisht, kryesisht në Nju Jork, Londër etj. dhe me qindra artikuj shkencorë në shtypin dhe periodikun e huaj. "Thelbi i punës sime është që ta bëj të njohur në botë kulturën shqiptare. Nuk shkon më që kultura e këtij populli evropian, më i madh se populli danez apo finlandez, të jetë fare i panjohur në botë," thotë ky mik i shqiptarëve.

**Bota sot:** *Duke ju uruar pranimin tuaj në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe duke ju përgëzuar për punën e madhe që keni bërë dhe po bëni si mik i shqiptarëve, më lejoni t'ju pyes se si u ndjetë kur moret vesh për pranimin tuaj në ASHAK?*

**Dr. Robert Elsie:** Në të vërtetë, u habita shumë këtu në fshatin tim gjerman. Është për mua një nder dhe një kënaqësi. Por, kam një kërkesë. Dua, ju lutem, të jem anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Republikës së Kosovës. A mundet?

**Bota sot:** *Me siguri, por, akademik Elsie, ju jeni nga Vankuveri i Kanadasë, jetoni në Olzheim të Gjermanisë, ndërsa jeni anëtar i Akademisë së Shkencave të Kosovës. Ju lutem, si keni rënë në kontakt me gjuhën dhe kulturën shqipe dhe prej kur merreni me albanologji?*

**Dr. Robert Elsie:** Që prej viteve të fëmijërisë kam qene i interesuar për gjuhë dhe kulturë të huaja. Bota shqiptare ishte e panjohur për mua për një kohë shumë të gjatë. Unë mbaj mend në gusht të vitit 1972, si student i ri, pashë për herë të parë disa shqiptarë në stacionin e trenit të Lucernit në Zvicër. Kishin në peron atë ecje të ngadalshme që kanë shqiptarët edhe sot, më kollë nga duhani, dhe flisnin një gjuhë interesante. Prandaj u afrova dhe pyeta se çfarë kombi ishin. Më thanë "Wir sind Albaner aus Kosovo", dhe kur hezitova pak, më thanë "Jugoslawien, Jugoslawien." Kaq ishte takimi i parë. Por, takimi vendimtar ishte më vonë. Unë mbarova studimet e mia në Universitetin e Bonit në Gjermani në vitin 1978, në një kohë kur profesori im kishte lidhje me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Befasisht, profesori mori

një ftesë për të vizituar Shqipërinë, bashkë me studentët e tij. Kështu, në verë të vitit 1978 u futëm për herë të parë në Shqipëri, në një planet tjetër, krejtësisht i ndarë nga bota jonë, më dukej. Parullat e propagandës kudo. Tamam si në ata filmat e Holivudit. Shqipëria sapo i kishte thyer marrëdhëniet me Kinën, dhe kishte shumë "gabime ideologjike" për të dënuar. Unë i shënova të gjitha gabimet në një defter për të mësuar shqip. Por, njerëzit në Shqipëri ishin përsëri shumë dashamirës me ne. E mbaj mend edhe sot. Pashë në sytë e tyre një dëshirë për të bërë muhabet, por nuk guxonin. Vetëm buzëqeshnin nga larg. Gjatë viteve që pasuan, kemi qenë shpeshherë në Shqipëri, deri në mes të viteve tetëdhjetë dhe, mbeta i mahnitur nga kjo kulturë tepër e veçantë.

Në fund të viteve shtatëdhjetë mora pjesë për herë të parë në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën Shqipe në Kosovë dhe fillova më seriozisht të mësoj gjuhën. Ishte një kohë e bukur në Kosovë. "Liri, barazi," njerëz të lirë, para se të fillonte prapë tmerri nga viti 1981. Kisha vështirësi të mëdha me gjuhën. Më dukej e pamundur të mësosh shqip. Pastaj, kaluan shumë vite para se të isha në gjendje të kuptoj më shumë se "gëzuar" dhe "s'ka problem". Gjuha që flitej në rrugët e Prishtinës dallonte nga gjuha letrare që kisha mësuar unë. Vetëm më vonë kuptova se pse ishte kështu.

**Bota sot:** *Dr. Elsie, deri më tani, keni botuar me dhjetëra dhe dhjetëra libra, kryesisht në SHBA, për letërsinë, kulturën shqiptare, gjendjen politike, por edhe qindra artikuj shkencore dhe recensa në periodikun dhe shtypin botëror. Si mendoni, sa është e njohur sot kultura shqiptare në botë?*

**Dr. Robert Elsie:** Kultura shqiptare mbetet fare e panjohur. Edhe sot. E vetmi ndryshim tani është që shqiptarët si popull janë të njohur në Evropë dhe në Amerikë. Ka shumë për t'u bërë në këtë drejtim dhe ky është thelbi i punës sime, që ta bëj këtë kulturë të njohur. Nuk shkon më që ky popull evropian, më i madh se populli danez apo finlandez, të mbetet i panjohur për ne si popujt e Azisë qendrore apo të Afrikës.

**Bota sot:** *Por, z. Elsie, edhe përkundrejt kësaj, kjo Histori e letërsisë shqiptare ende mbetet e vetmja histori e letërsisë dhe që ka një përfshirje gjithëshqiptare së autorëve. Përse edhe pas 10 vitesh të rënies së monizmit, studiuesit shqiptarë nuk i rreken punës për të bërë një histori të paideologjizuar të letërsisë shqiptare?*

**Dr. Robert Elsie:** Arsyeja e mungesës së veprave shkencore bazë në Shqipëri nuk është që nuk ka njerëz të aftë për këtë punë, por është thjesht punë paraje. Kush mund të jetojë në Tirranë me një rrogë të tillë dhe të punojë në kushte të tilla? Instituti i Gjuhësisë të kujton një godinë që ka pësuar një tërmet. Unë i kuptoj mirë shkencëtarët shqiptarë që preferojnë të emigrojnë në Kanada apo në Shtetet e Bashkuara. Është tragjedi e madhe që Shqipëria nuk ka patur dhe ende nuk ka fonde për të mirëmbajtur aparatit shkencor në vend. Shumë intelektualë kanë ikur dhe shumë të tjerë punojnë kamarierë, ku fitojnë më shumë. Në bazë të botimeve të viteve të fundit që kam parë unë, kam përshtypjen se jeta intelektuale dhe puna shkencore në Shqipëri gjenden në krizë. Shpresoj ta kem gabim.

**Bota sot:** *Në një artikull letrar të para tetë viteve theksoni: Një kulturë, dy realitete. Si mendoni, çfarë realitetesh do të krijohen në të ardhmen mes Kosovës dhe Shqipërisë?*

**Dr. Robert Elsie:** Dy realitete, me siguri! Në atë kohë ishte tabu i madh të thuash kështu, por më duket ndërkohë që shqiptarët vetë pranojnë, apo fshehtazi e ndiejnë këtë. Në anën tjetër mendoj që ndarja midis shqiptarëve të Shqipërisë dhe të Kosovës (mos harrojmë dhe ata të Maqedonisë dhe Malit të Zi, etj.), do s'do, po zhduket më shpejt se kurrë. Shqiptarët nuk janë

më të huaj për njëri-tjetrin, siç kanë qenë para pesë-tetë viteve. "Vizita e shkurtër" e popullit të Kosovës përtej malit në vitin 1999, përpos tragjediave, ka patur një anë të mirë. Për herë të parë shqiptarët kanë ndierë ngrohtësinë vëllazërore.

**Bota sot:** Në librin historiko-analitik dhe publicistik "Kosova në zemër të fuçisë së barutit" (*Kosovo in the Heart of the Powder Keg*) që e keni botuar më 1997 në Nju Jork, çështjen shqiptare në ish-shtetin titist e keni analizuar dhe paraqitur duke iu referuar fakteve të shumanshme dhe një bibliografie tepër voluminoze. Zoti Elsi, si ju duket sot Kosova?

**Dr. Robert Elsie:** Kaotike, e turbulluar dhe... e mrekullueshme! Nuk ka gjë që më jep më shumë kënaqësi në jetë sesa të shoh Kosovën e lirë pas kaq shumë viteve të tmerrit. Ndoshta është pjesa e kulturës shqiptare që kosovarët kanë vuajtur për shumë vite në heshtje. Është një popull fisnik, që meriton të jetojë më mirë tani. Jam shumë optimist për të ardhmen e Kosovës. Janë punëtorë, e duan vendin e tyre dhe, do ta zhvillojnë shpejt, shumë shpejt, më shpejt se viset e tjera shqiptare.

**Bota sot:** Po në këtë libër, mes të tjerash, ju keni shtruar edhe këtë pyetje: cili është dallimi mes marrëdhënieve shqiptaro-serbe dhe shqiptaro-maqedone? A mundeni sot që ju t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje, duke e vështruar këtë në kohë dhe hapësirë të ndryshme?

**Dr. Robert Elsie:** Nuk jam shumë në dijeni për situatën e tanishme në Maqedoni, por e di që ende ka shumë padrejtësi. Është vështirë të jetosh aty si shqiptar dhe të ballafaqohesh ditë për ditë me faktin se je qytetar i rendit të dytë. Por edhe në Tetovë dhe Gostivar, shqiptarët do të kenë durim. Me demokratizimin e Maqedonisë, që do të vijë, sepse edhe ajo është pjesë e Evropës, problemet do të zbuten dhe gabimet do të korrigjohen. Kam ndërmend të vij një ditë për të bërë një vizitë në Universitetin e Tetovës, dhe do të vij. Popujt e këtij vendi kanë mbijetuar krizën e vitit 1999, dhe në një farë mënyre kanë mësuar që janë të varur prej njëri-tjetrit.

Intervistoi: Hasan Salihu.

[Botuar në gazetën: *Bota sot*, Prishtinë, 10 janar 2001, f. 7]